

MARRËDHËNIET NDËRETNIKE NË KOSOVË NGA PERSPEKTIVA E KOMUNITETEVE RAE





MARRËDHËNIET NDËRETNIKE NË KOSOVË NGA PERSPEKTIVA E KOMUNITETEVE RAE

LIRIJE PALUSHI

Gusht 2020

Qëndrimet e paraqitura në këtë punim nuk paraqesin doemos qëndrimet e Fondacionit-Konrad-Adenauer.

HYRJE:

Me popullsi të përgjithshme prej më pak se 1.8 milion banorë, popullsia e Kosovës është mjaft e larmishme. Tridhjetetë nga 38 komunat në Kosovë janë shumë etnike dhe përbëhen nga disa grupe etnike të njohura me ligj si “komunitete”. Meqenëse regjistrimi zyrtar i vitit 2011 ishte bojkotuar gjerësisht nga serbët e Kosovës, zakonisht merren parasysh të dhënat e siguruar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Sipas vlerësimeve të tyre, Shqiptarët etnikë përbëjnë 87% të popullsisë, Serbët përbëjnë 8% të popullsisë, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga grupe më të vogla etnike, përkatësisht Turq, Boshnjakë, Romë, Ashkali, Egjiptianë dhe Goranë. (Ekzistojnë dy grupe të tjera, Kroatët dhe Malazezët, të cilat u njohën si komunitete pas shpalljes së pavarësisë, prandaj nuk përfshihen në kushtetutën e Kosovës (ECMI Kosovo, 2013).

Për shkak të klimës aktuale politike dhe narracionit historik, marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë zakonisht shihen përmes thjerrëzave të marrëdhënieve ndërmjet Shqiptarëve dhe Serbëve të Kosovës, ku që të dy e mbizotërojnë politikën e Kosovës. Siç pritej, studime të shumta u kryen me fokus në marrëdhëniet ndërmjet dy grupeve, shpesh duke i lënë grupet tjera etnike më të vogla jashtë ekuacionit si dhe debatin e përgjithshëm për avancimin e të drejtave të tyre dhe përmirësimin e gjendjes aktuale, si parakusht për një shoqëri të qëndrueshme shumetnike dhe demokratike në Kosovë.

Deri më sot, Kosova ka çaluar në integrimin e plotë të pakicave në jetën politike, sociale dhe ekonomike të vendit dhe në pajtueshmërinë me kornizën ligjore kombëtare dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e pakicave. Një nga argumentet dhe konkluzionet kryesore të nxjerra në lidhje me gjendjen e të drejtave të pakicave në Kosovë është se ligjet janë “perfekte në letër” vetëm se mungon një mekanizëm zbatimi për ta garantuar realizimin e të drejtave të pakicave.

Kjo përmbledhje e politikave argumenton se qytetarët e klasës së dytë, të nën-përfaqësuar e të diskriminuar në pothuajse të gjithë treguesit, janë tre grupet etnike: Romë, Ashkali dhe Egjiptianë (në tekstin e mëtejshëm, RAE). Kështu, ajo synon ta analizojë gjendje aktuale të komuniteteve RAE si prapavijë për t'i analizuar marrëdhëniet ndër-komunitare në Kosovë dhe të jep rekomandime për hisedarët relevant dhe publikun e gjerë.

KORNIZA LIGJORE

Kushtetuta e Kosovës, si akti më i lartë juridik, e përkufizon Kosovën si një shoqëri shumetnike të përbërë nga Shqiptarët dhe komunitetet tjera. I njëjti nen në kushtetutë i nënvizon edhe parimet e barazisë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjes nga të gjitha Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre (Constitution of the Republic of Kosovo, 2008). Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës e ka një kapitull të veçantë për të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarët e tyre. Më e rëndësishmja, përfaqësimi i të gjitha komuniteteve garantohet përmes organit më të lartë legjislativ, Kuvendit të Kosovës, ku 20 nga 120 ulëset janë të garantuara për të gjitha komunitetet pakicë që banojnë në Kosovë (po aty). Nga këto 20 ulëse, komunitetet RAE e kanë nga një ulëse të garantuar në Kuvendin e Kosovës dhe një ulëse shtesë i jepet komunitetit Rom, Ashkali ose Egjiptian me numrin më të madh të votave. Zakonisht, kjo ulëse merret nga partitë politike të mbështetura nga Ashkalitë (ECMI Kosovo, 2013).

Korniza ligjore e Kosovës për të drejtat e komuniteteve është mjaft e pasur për sa i përket larmisë së legjislacionit të miratuar pas shpalljes së pavarësisë, bazuar kryesisht në Planin e Ahtisaarit të vitit 2007. Përveç Kushtetutës, ekzistojnë katër ligje që adresojnë posaçërisht mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë:

- Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Kosovë;
- Ligji për përdorimin e gjuhëve
- Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi;
- Ligji për vetëqeverisjen lokale;

Seksioni vijues i këtij punimi shkurtimisht do ta diskutojë secilën nga katër pjesët kryesore të legjislacionit për ta dhënë një pamje të qartë të disa të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga këto ligje në lidhje me mbrojtjen e komuniteteve RAE në veçanti.

LIGJI PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE NË KOSOVË

Së bashku, Ligji për mbrojtjen dhe të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë dhe Ligji për përdorimin e gjuhës janë ligjet më të rëndësishme që krijojnë të drejtat e komuniteteve (ECMI Kosovo, 2013). Ligji për mbrojtjen dhe të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë posaçërisht synon promovimin e paqes, tolerancës, dialogut ndërkulturor dhe ndërfetar, si dhe përkrahjen për pajtim ndërmjet komuniteteve. Ai gjithashtu përmban shumë dispozita për të drejtat e identitetit; përdorimin e gjuhëve; arsimin, mundësitë ekonomike dhe sociale; mediat, fenë, shëndetësinë dhe të drejtat e pjesëmarrjes politike; dhe krijimin e një Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK) nën patronazhin e Presidentit të Kosovës (Law No. 03/L-047, 2008). Sidoqoftë, nuk ka të dhëna të disponueshme për përbërjen ose punën procedurale të KKK-së në uebsajtin zyrtar të Presidencës së Kosovës.

Ligji për mbrojtjen dhe të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë gjithashtu parashikon zhvillimin e programeve të punësimit publik dhe iniciativave të tjera që synojnë tejkalimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe indirekt ndaj personave që i përkasin komuniteteve, me konsideratë të veçantë për komunitetet RAE (Law No. 03/L-047, 2008).

LIGJI PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Ligji për përdorimin e gjuhëve u miratua në vitin 2006 me qëllim të sigurimit të statusit të barabartë të gjuhëve shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare dhe të barabarta të Kosovës, për ta respektuar identitetin gjuhësor të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe për ta siguruar përdorimin e gjuhëve për komunitetet, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare në institucionet e Kosovës, duke i ngritur kështu gjuhët turke, boshnjake dhe rome si gjuhë në përdorim zyrtar në nivelin komunal (Law No.02/L-37, 2006). Nëse një komunitet përbën të paktën 5% të popullsisë në një komunë të caktuar, gjuha e saj amtare e fiton statusin e gjuhës zyrtare në atë nivel komunal. Kjo ndryshon nga gjendja në të cilën gjuha konsiderohet gjuhë në përdorim zyrtar nëse është gjuhë amtare e të paktën 3% e popullsisë së përgjithshme të komunës (po aty).

LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Neni i parë i Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi e përkufizon qëllimin e vet ligjit, duke treguar se qëllimi i gjithëmbarshtëm është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë (Law Nr. 05/L -021, 2015).

Ligji e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në paragrafin e mësipërm që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose çënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin të të drejtave dhe lirive themelore të njohura. Shembuj të trajtimeve të pabarabarta përfshijnë diskriminimin e drejtpërdrejtë, diskriminimin e tërthortë, ngacmimin, nxitjen për të diskriminuar, viktimizimin dhe segregacionin (po aty).

LIGJI PËR VETËQEVERISJE

Ligji për vetëqeverisjen lokale e përkufizon “komunitetin” si grup komuniteti që i përkasin një grupi të njëjtë etnik, fetar apo gjuhësor (Law Nr. 03/L-040, 2008). Ligji parasheh ngritje të kompetencave komunale për komunat e caktuara në fushat e shëndetësisë, arsimit, çështjeve kulturore dhe të drejtës pjesëmarrëse në zgjedhjen e komandantëve vendorë të policisë. Më konkretisht, kompetencat e zgjeruara në kujdesin dytësor shëndetësor u jepen Komunave të Mitrovicës Veriore, Graçanicës dhe Shtërpcës, kompetencat e zgjeruara në shkollimin universitar i jepen Komunës së Mitrovicës Veriore, ndërsa të gjitha komunat në të cilat serbët e Kosovës janë shumicë kanë kompetenca të zgjeruara në fushën e kulturës dhe për zgjedhjen e komandantëve lokalë të stacioneve të policisë.

Për më tepër, ligji rregullon krijimin e Komitetit të Komuniteteve përgjegjës për shqyrtimin e politikave, praktikave dhe aktiviteteve komunale me qëllim të sigurimit të respektimit të të drejtave dhe interesave të Komuniteteve. Ai gjithashtu specifikon se në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, posti i zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve (po aty).

INFORMATË E PËRGJITHSHME LIDHUR ME KOMUNITETET RAE

Bazuar në vlerësimet e OSBE-së, popullsia romë ka numër më të madh të qytetarëve në Kosovë krahasuar me popullsinë Ashkali dhe Egjiptiane. Në Kosovë jetojnë rreth 15,696 romë (ose afërsisht 0.84% e popullsisë), ku shumica e të cilëve banojnë në Prizren, Graçanicë dhe Pejë. Numërimi është pak më i ulët për komunitetin Ashkali me gjithsej rreth 15,546 qytetarë (ose rreth 0.83% të popullsisë së përgjithshme). Shumica e komunitetit Ashkali banon në Ferizaj, Fushë Kosovë dhe Lipjan. Në fund, komuniteti egjiptian përfshinë numrin më të vogël në mesin e komuniteteve RAE me rreth 11.524 qytetarë (rreth 0.64% të popullsisë) që kryesisht banon në Gjakovë, Pejë dhe Istog (ECMI Kosovo, 2013).

Komunitetet Ashkali dhe Egjiptiane e kanë gjuhë shqipe si gjuhë amtare. Kjo mund të konsiderohet si avantazh kur bëhet fjalë për qasjen në arsim dhe në institucionet publike. Sidoqoftë, romët gjuhë amtare e kanë gjuhën romë, prandaj flasin shqip ose serbisht si gjuhë të dytë, varësisht nga lokacioni ku banojnë në Kosovë.

Komunitetet RAE kanë shumë ngjashmëri sa i përket çështjeve kulturore dhe socio-ekonomike. Për këtë arsye ato shpesh studiohen veçmas nga komunitetet e tjera që jetojnë në Kosovë. Edhe pse bashkërisht ato përbëjnë mbi 2% të popullsisë së përgjithshme, situata e tyre mbetet e pafavorshme pasi ato përbëjnë grupet më të cenueshme dhe të marginalizuara brenda shoqërisë. Kjo qëndron për dallim nga fakti se kanë kaluar 20 vjet nga lufta e Kosovës, 12 vjet që kur Kosova e shpalli pavarësinë, dhe po aq vite që kur të drejtat e tyre u mbrojtën me kushtetutë.

Ndërsa të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë përballen me sfida dhe kanë nevoja specifike për shkak të gjendjes aktuale socio-politike dhe ekonomike, komunitetet RAE, posaçërisht përballen me vështirësi në çdo sferë të jetës. Një studim gjithëpërfshirës nga UNDP dhe Banka Botërore konfirmon se komunitetet RAE, siç diskutohet në detaje më poshtë, janë grupet më të përjashtuara në çdo aspekt të zhvillimit njerëzor: të drejtat themelore, kujdesi shëndetësor, arsimi, strehimi, punësimi dhe standardi i jetesës (UNDP, World Bank, 2018). Për më tepër, edicioni i fundit i raportit të Vlerësimit të Komunitetit të OSBE-së thekson në mënyrë të qartë nevojën e menjëhershme për integrimin e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të vendit (OSCE, 2015).

Me kalimin e viteve kishte përpjekje, të paktën ligjërish, për ta trajtuar përfshirjen e komuniteteve RAE. Në veçanti një përpjekje është “Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2020”. Megjithëse nuk është e para e këtij lloji, ajo shërben si pasuese e strategjisë paraprake të hartuar pas shpalljes së pavarësisë në 2008. Qëllimi i strategjisë, siç përcaktohet në dokumente, është të shërbejë për ta forcuar karakterit multi-etnik dhe multi-kulturor të shoqërisë kosovare (Office of the Primeminister, 2017). Dokumenti identifikon katër fusha prioritare që duhen adresuar në përputhje me kornizën e BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritit të Romëve deri në vitin 2020, përkatësisht arsimin, punësimin dhe mirëqenien sociale, shëndetësinë dhe strehimin.

Sidoqoftë, nuk ka informata se çka ka arritur Plani i Veprimit i Strategjisë dhe sa nga objektivat e përcaktuara janë përmbytur. Disa studime dhe raporte të kryera ndër vite e theksojnë këtë shqetësim. Për shembull, raporti i Komisionit Evropian për vitin 2019 thotë se niveli i zbatimit të strategjisë mbetet i dobët dhe nuk vlerësohet sistematikisht (European Commission, 2019). Në mënyrë të ngjashme, raporti i vlerësimit të komunitetit nga OSBE nënvizon edhe dështimin e institucioneve të Kosovës për ta zbatuar planin e veprimit (OSCE, 2015).

Deri më sot, shumica e projekteve që merren me përmirësimin e komuniteteve RAE që jetojnë në Kosovë janë të lidhura me bashkësinë ndërkombëtare dhe shoqërinë civile në Kosovë, do të thotë të drejtuara nga donatorët. Ndërsa është e kuptueshme që të drejtat e pakicave janë lartë në agjendën e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë, ato nuk janë fare prioritet për qeveritë në Kosovë, e cila duket se e percepton integrimin e plotë të komuniteteve RAE si “përgjegjësi” e “të tjerëve” (do të thotë bashkësisë ndërkombëtare dhe shoqërisë civile) e jo si parakusht për shtet demokratik e funksional shumetnik ose detyrim ligjor që rrjedh nga korniza ligjore.

Në seksionin e mëposhtëm, kjo përmbledhje do të fokusohet kryesisht në zbrërthimin e disa prej sfidave kryesore rreth komuniteteve RAE. Sigurisht se nuk është listë shteruese, duke pasur parasysh natyrën komplekse të situatës, por jep një tregues të problemeve që i rrethojnë këto komunitete.

ARSIMI

Arsimi është padyshim burim thelbësor që i siguron secilit brez të ri njohuri dhe aftësi, jo vetëm për punësim në të ardhmen, por edhe për vetëdijen dhe pjesëmarrjen civile dhe politike. Arsimi është shpesh një tregues i pozitës së përgjithshme shoqërore të një grupi etnik social brenda shoqërisë. Fatkeqësisht, arsimi për komunitetet RAE konsiderohet ende luks më shumë sesa e drejtë e garantuar. Megjithë përmirësimet në fushën e arsimit ndër vite, disa nga sfidat kryesore kur bëhet fjalë për arsimimin në mesin këtyre grupeve etnike janë qasja në arsim, niveli i braktisjes së shkollimit (sidomos në mesin e vajzave), nivelet e ulëta të arritjes dhe motivimit, bullizmi dhe diskriminimi/segregacioni nëpër shkolla dhe barrierat gjuhësore (veçanërisht për komunitetin Rom).

Sipas vlerësimeve të fundit nga UNDP, qasja në arsimin parashkollor është përgjithësisht e ulët për të gjithë fëmijët që jetojnë në Kosovë (29%). Sidoqoftë, për fëmijët Rom është ndër më të ulëtat, me vetëm 24%. Sidoqoftë, duhet të theksohet se arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm sipas ligjit për arsimin parafillor, por mund të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në nivelin e performancës në arsimin e mëvonshëm (UNDP, World Bank, 2018). Për shembull, një studim i kohëve të fundit nga UNICEF konkludon se fëmijët që ndjekin arsimin parashkollor kanë mes tjerash mësimnxënie dhe performancë më të mirë akademike në gjuhë dhe në matematikë dhe kanë potencial për pagë më të lartë më vonë në jetë (UNICEF, 2020).

Ndërsa niveli i përgjithshëm i regjistrimit në arsimin e detyrueshëm (i cili përfshinë arsimin fillor dhe të mesëm të ulët) është rreth 96%, niveli i regjistrimit bruto në arsimin e detyrueshëm për fëmijët RAE është 85% (MEST, 2016). Numri i atyre që e mbarojnë arsimin e detyrueshëm është edhe më i ulët (60%), dhe shfaqen pabarazitë në mes të djemve dhe vajzave, që do të thotë se përqindja e vajzave që e mbarojnë arsimin e detyrueshëm është më e ulët se ajo e djemve (UNDP, World Bank, 2018). Të dhënat tjera nga Agjencia e Statistikave të Kosovës gjithashtu kanë treguar rezultate brengosëse për treguesit e arsimit në nivel vendi. Për shembull, ndërsa niveli i shkrim-leximit në mesin e të rinjve të moshës 15-24 në nivel kombëtar është rreth 98% si për femrat ashtu edhe për meshkujt, përqindjet janë dukshëm më të ulëta për komunitetet RAE: respektivisht, 73% dhe 87% (The Kosovo Agency of Statistics, 2014).

Për t'iu kundërvënë këtyre sfidave, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e ka aprovuar Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021 në të cilin janë paraparë disa masa për t'i arritur objektivat në lidhje me arsimimin e fëmijëve RAE (Office of the Prime Minister, 2017). Ngjashëm me strategjinë për përfshirje, plani strategjik nënvizon përfshirjen e pjesëtarëve të grupeve shoqërore të marginalizuara të RAE në të gjitha nivelet e arsimit me fokus të veçantë në arsimin parashkollor dhe të mesëm të lartë duke marrë parasysh nivelet e ulëta të pjesëmarrjes. Për shembull, plani parashikon rritje për 10% të përfshirjes së fëmijëve në arsimin fillor dhe 20% në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (MEST, 2016).

Ende nuk ka politika efektive administrative dhe financiare për ta stimuluar arsimin midis komuniteteve RAE. Në disa raste, sigurimi i transportit është sfidë që çon në rritjen e niveleve të braktisjes së shkollimit. Për shembull, transporti nuk u sigurohet rregullisht nxënësve Ashkali nga disa fshatra në Graçanicë dhe Lipjan dhe nxënësve Rom në Gjilan, Novobërdë dhe Shtërpcë që vijojnë shkollimin sipas kurrikulave të Kosovës (OSCE, 2018). Efekti i këtij trendi shoqërohet me mungesën e njohurive, mungesën e rëndësisë së arsimit dhe statusin e përgjithshëm socio-ekonomik të këtyre komuniteteve.

Disa studime të monitorimit tregojnë gjithashtu se segregacioni në shkollë vazhdon, ku zakonisht nxënësit RAE ulen në pjesën e prapme të dhomës mësimore ose në disa raste më ekstreme madje futen në dhoma mësimore të ndara. Disa shembuj janë rasti i dy dhomave mësimore të segreguara në Gjakovë, një në Ferizaj dhe dy dhomave mësimore të segreguara Pejë (ECMI Kosovo, 2013). Rastet e tilla janë shembull i drejtpërdrejtë i diskriminimit të paligjshëm, por gjithashtu tregojnë për mungesë të njohurisë nga stafi i shkollës, mësimdhënësit dhe prindërit për t'i raportuar dhe dënuar rastet e ngjashme të diskriminimit.

Meqenëse komunitetet Ashkali dhe Egjiptianë e kanë gjuhën shqipe si gjuhë amtare, gjuha nuk është pengesë kur bëhet fjalë për qasjen në arsim siç parashikohet nga MASHT. Sidoqoftë, institucionet e Kosovës nuk ofrojnë arsim gjithëpërfshirës në gjuhën rome, ndërsa për komunitetin Rom që banon në komunat me shumicë serbe, nxënësit Rom vijojnë mësimet në sistemin arsimor paralel në gjuhën serbe të siguruar nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë. Ndërsa duhet të theksohet se

MASHT ka bërë disa përpjekje për të siguruar mësim në gjuhën Rome në Prizren, duke përfshirë elementë të kulturës dhe historisë rome dhe botimin e librit të parë në gjuhën rome në 2015 (OSCE, 2015), ky është shembulli i vetëm i përpjekjeve të tilla kurse efektet ende duhet të shihen.

Sa i përket arsimit terciar, ekzistojnë kuota të veçanta të rezervuara për studentët e pakicave në sistemin e Arsimit të Lartë të Kosovës. Sidoqoftë, numri i studentëve RAE që ndjekin studimet e arsimit të lartë është i kufizuar. Sa për ilustrim, vetëm 62 studentë RAE ishin të regjistruar në Universitetin e Prishtinës gjatë vitit akademik 2017-2018 — vetëm 0,18% e 34,324 studentëve (Kosovo Agency of Statistics , 2018). Për më tepër, janë raportuar disa abuzime të kuotave nga studentët që nuk i përkasin komuniteteve pakicë me ndihmën e individëve të caktuar brenda partive politike (ECMI Kosovo, 2015).

Në Kosovë, arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës formal dhe joformal mund të luajë rol thelbësor në nxitjen e marrëdhënieve ndëretnike si platformë për ndërtimin e paqes si një shans për t'i arsimuar të rinjtë në frymën e multikulturalizmit dhe tolerancës. Arsimi joformal në përgjithësi kuptohet si aktivitet arsimor jashtë sistemit formal të arsimit të vendit (shkollimi i detyrueshëm), por aty ku ekziston qëllimi arsimor dhe planifikimi i aktiviteteve mësimdhënëse/mësimnxënëse. (Lafraya, 2011).

Siç e kemi parë nga disa shembuj të mësipërm, janë shumë fusha të mundshme të ndërhyrjes dhe me planifikimin e duhur të objektivave dhe aktiviteteve mësimore, arsimi joformal sigurisht se mund të ketë ndikim pozitiv në trajtimin e çështjeve ekzistuese siç janë përjashtimi social, diskriminimi dhe segregacioni, fjalimi i urrejtjes, nivelet e larta të braktisjes së shkollimit, etj. Deri më tani, sigurimi i arsimit joformal përfshirë trajnimet, seminarët, konferencat etj. është bërë i mundur përmes OJQ-ve lokale, organizatave dhe fondacioneve ndërkombëtare, dhe nga vrojtimet e nxjerra nga fusha, nismat e tilla mund të kenë një rol transformues në mes të komuniteteve, prandaj duhet të promovohet fuqimisht.

Arsimi zyrtar që ofrohet nga institucionet publike dhe private dhe të licencuara nga MASHT fatkeqësisht përballet me sfida të jashtëzakonshme dhe kritikohet për mungesën e përgjithshme të planifikimit cilësor dhe të dobët që në përgjithësi kërkon më shumë kohë për transformim. Për dallim arsimit joformal është shumë më fleksibil dhe duhet të shihet si një mundësi e vazhdueshme dhe një tipar shtesë i arsimit zyrtar për ta ndryshuar 'status quo' në raport me marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë. Duhet të theksohet edhe një herë se problemet me të cilat përballen komunitetet RAE janë të natyrës së ndryshme nga ato që përjetohen nga Shqiptarët dhe Serbët, dhe ky është një kusht që ofruesit e arsimit joformal duhet ta mbajnë në mend.

Hulumtimet nga disa studime të rasteve të vendeve pas konfliktit dhe përfshirjes sociale të minoriteteve përmes arsimit joformal në tërë botën kanë treguar se arsimit joformal mund të ketë ndikim pozitiv në ndërtimin e besimit ndërmjet grupeve etnike pasi iniciativat arsimore joformale e kanë potencialin për ta nxitur dialogun, ndërtimin e konsensusit, vlerësimin e të tjerëve etj. (Datzberger, 2016); (Mareva, 2017); (Urias, 2016). Sidoqoftë, arsimit joformal stimulohet dhe inkurajohet fuqishëm edhe në vendet e zhvilluara. Bashkimi Evropian i kushton vëmendje të veçantë punës së të rinjve dhe arsimit joformal. Për shembull, në vitin 2014, Këshilli e miratoi planin e punës të BE-së për të rinjtë duke i dhënë përparësi mësimi joformal, si një rrugë për ta promovuar bashkëpunimin ndër-sektorial, përfshirjen sociale, shëndetin dhe mirëqenien etj. (European Commission, 2015).

Për këtë arsye, qeveria e Kosovës së bashku me organizatat ndërkombëtare dhe atyre në nivel të rrënjës që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe të pakicave duhet t'i japin përparësi investimit në arsim joformal, si një mundësi për t'u siguruar komuniteteve RAE jo vetëm me mundësi arsimore më të mira, por edhe të shërbejë si mjet fuqizimi dhe një shans për t'i arsimuar dhe emancipuar të rinjtë dhe, rrjedhimisht, të thyejnë stereotipet dhe paragjykimet etnike ndaj të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe komuniteteve RAE në veçanti.

Në këtë drejtim, ekziston nevoja e menjëhershme që qeveria e Kosovës ta rimendojë se si do të alokohen fondet e arsimit dhe të sigurojnë qëndrueshmërinë e nismave arsimore joformale dhe organizatat e shoqërisë civile t'i ri-mendojnë objektivat dhe qëllimet e tyre mësimore për vitet e ardhshme. Arsimit joformal në përgjithësi është i orientuar drejt të rinjve me më pak mundësi dhe duke i afruar ata nga margjinat më afër qendrës së shoqërisë. Duke vepruar kështu, ofruesit e arsimit joformal inkurajojnë një sens të tolerancës dhe përkatësisë në mesin e të rinjve kosovarë. Për sa kohë që nuk ndodh, marrëdhëniet e shëndetshme ndër-komunitare do të mbeten vetëm skenar hipotetik për Kosovën.

(PA) - PUNËSIMI

Megjithëse Kosova ka një nga popullsitë më të reja në Evropë, komunitetet RAE përbëjnë popullsinë më të re në krahasim me komunitetet tjera në Kosovë përfshirë shqiptarët. Shihni tabelën krahasuese më poshtë:

Komuniteti	Shqiptarë	Serbë	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptianë	Turk	Goran
Mesatarja e moshës	29.4	37.6	34	25.2	24	26.1	32.6	34.6

Burimi: (ECMI Kosovo, 2013)

Kjo gjendje mund të duket se është e dobishme, pasi fuqia punëtore e re në moshë mund të përshtatet më mirë në tregun e punës. Sidoqoftë, kjo mospërputhje moshe ndërmjet komuniteteve etnike në Kosovë është më pak thelbësore, pasi situata ekonomike e komuniteteve RAE është dukshëm më e cenueshme në krahasim me komunitetet tjera në Kosovë, duke marrë parasysh situatën e përgjithshme ekonomike në Kosovë, si një nga vendet më të varfra në Evropë.

Në fakt, papunësia mbetet ndër çështjet kryesore brengosëse për qytetarët e Kosovës (UNDP, 2020). Sidoqoftë, për grupet e marginalizuara dhe të diskriminuara siç janë komunitetet RAE, gjendja është më e rëndë. Një faktor domethënës, siç u diskutua më lart, është niveli i arsimimit dhe aftësisimit - ose mungesa e tyre - për studentët RAE. Për shembull, një studim i kryer nga UNDP në vitin 2013 tregon se në komunat e Obiliqit dhe Fushë Kosovës niveli i punësimit ishte thjesht 7% për komunitetin Ashkali. Për më tepër, ky komunitet e kishte nivelin më të ulët të të ardhurave, me vetëm 132.5 Euro në muaj, krahasuar me të ardhurat prej 446.5 për familjen mesatare shqiptare (Shaipi, 2013).

Ky konstatim është në kontrast të madh me normat e punësimit në Kosovë, në nivelin kombëtar dhe më gjerësisht në rajon. Sipas vlerësimeve të fundit të UNDP në tregjet e punës në Ballkanin Perëndimor, norma e papunësisë së përgjithshme të fuqisë totale të punës në Kosovë është 49%. Për komunitetin rom, kjo normë është 78% (88% për gratë). Për më tepër, 74% e romëve punojnë në sektor joformal (UNDP, World Bank, 2018).

Kjo statistikë është shqetësuese, pasi që përfshirja e lartë në punë joformale është tregues i riskut për paqëndrueshmëri financiare dhe pasiguri ekonomike në mesin e amvisërive dhe të ardhurave mujore. Raportet nga ECMI nga të dhënat e marra nga UNDP në fillim të vitit 2011, edhe pse relativisht të vjetruara, gjithashtu tregojnë të dhëna të ngjashme lidhur me normën e papunësisë prej mbi 60% për Romët dhe Ashkalitë, ndërsa për komunitetin Egjiptian në rreth 80% (ECMI Kosovo, 2013).

Një tregues tjetër i gjendjes së dobët ekonomike dhe niveleve të diskriminimit për komunitetet RAE është përfaqësimi i tyre në shërbimin civil të Kosovës. Studimi i OSBE-së 2017 për përfaqësimin e komuniteteve në shërbimin civil zbulon se këto komunitete janë komunitetet më të nën-përfaqësuara në shërbimin civil proporcionalisht me pjesëmarrjen e tyre në shoqëri (OSCE, 2017). Ndërsa Romët dhe Ashkalitë përbëjnë nga 0.84% të popullsisë, ato përbëjnë vetëm 0.20% të shërbimit të përgjithshëm civil në Kosovë. Gjendja nuk është më e mirë për komunitetin egjiptian pasi ata përbëjnë vetëm 0.1% të shërbimit civil në Kosovë (kurse përbëjnë 0.64% të popullsisë) (ECMI Kosovo, 2013). Në numra të saktë, për shembull në 2015 ishin vetëm 13 Romë, 17 Ashkali dhe 9 Egjiptianë brenda Policisë së Kosovës, ndërsa asnjë nga pjesëtarët e RAE nuk është pjesë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (OSCE, 2015). Përkundër kësaj, serbët e Kosovës dhe turqit e Kosovës mbi-përfaqësohen si përqindje e popullsisë së përgjithshme. Sidoqoftë, kjo nuk është në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civil i cili parashikon përfaqësimin e komuniteteve pakicë përmes kuotës prej 10% në nivelin qendror dhe një përfaqësim proporcional me përbërjen demografike në nivelin lokal (Official Gazzete of the Republic of Kosovo, 2010).

Këta faktorë janë të ndërlidhur ngushtë me qasjen e përgjithshme dhe me cilësinë e arsimit që çon në mungesë të kualifikimeve profesionale, mungesë informacioni dhe diskriminim në baza etnike. Mungesa e qasjes në mundësi punësimi lidhet me kërkesën e lartë për emigrim në mesin e të rinjve të komuniteteve RAE.

QASJA NË INSTITUCIONET DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Treguesit shtesë tregojnë për gjendjen aktuale të komuniteteve RAE dhe përgjithësisht për kushtet e tyre të jetesës si dhe aftësinë e tyre për qasje në institucione dhe shërbime publike pa u ballafaquar me pengesa. Parakushti i parë për qasje në shërbimet publike, përfshirë qasjen në arsim, punësim, shërbime shëndetësore, shërbime sociale etj. është pasja e dokumentit të identitetit që për komunitetet RAE është ende sfidë. Ndërsa 97% e Romëve të marginalizuar kishin certifikata të lindjes, më pak se 90% e romëve mbi 16 vjeç janë të pajisur me letërnjoftim (UNDP, World Bank, 2018). Kjo është për shkak të mungesës së vetëdijes dhe njohurisë në mesin e komunitetit Rom, nga njëra anë, dhe mungesës së këmbënguljes institucionale për ta siguruar mbulesën në nivel kombëtar, nga ana tjetër. Ndërsa kjo mund të duket e parëndësishme në fillim, ajo pengon aftësinë e tyre për të gëzuar të drejta të tjera, si regjistrimi në shkollë, marrja e shërbimeve publike, etj. Ndërsa nuk ka të dhëna të sakta të kohëve të fundit, një studim i UNHCR tregon se në vitin 2015 ishin rreth 600 pjesëtarë të paregjistruar të komuniteteve RAE në Kosovë (Office of the Primeminister, 2017).

Një nga brengat më të mëdha është mbulimi shëndetësor i cili mbetet i kufizuar për komunitetin RAE. Pavarësisht nga fakti që mbulimi shëndetësor është çështje kombëtare dhe ndikon në komunitetet pakicë dhe shumicë, komunitetet RAE posaçërisht përballen me diskriminim dhe segregacion në marrjen e shërbimeve shëndetësore publike. Për shembull, një studim mbi Cilësinë e Kujdesit Antenatal në Kosovë konkludon se gratë e komuniteteve të tilla marrin sasi më të ulët dhe cilësi më të dobët të kujdesit para lindjes, për dallim nga gratë shqiptare dhe ato serbe (Stojanovski , Holla, Hoxha, Howell , & Janevic, 2017). Nëse merret parasysh gjendja ekonomike e pafavorshme e këtyre komuniteteve dhe kostoja e lartë e kujdesit shëndetësor, gjendja bëhet edhe më e rëndë, për shembull në një studim të vitit 2013, 80% e të anketuarve Romë, 78% e të anketuarve Ashkali dhe 75% e të anketuarve Egjiptianë deklaruan se hasën vështirësi në blerjen e ilaçeve. Nga ana tjetër, vetëm 27% e Shqiptarëve raportuan kushte të ngjashme (Shaipi, 2013). Përveç barrës financiare, distancat e gjata në objektet shëndetësore dhe koha e gjatë e pritjes janë pengesa shtesë me të cilat përballen komunitetet RAE gjatë qasjes në shërbime shëndetësore (Office of the Primeminister, 2017).

Në fund, kur bëhet fjalë për strehimin, përveç se jetojnë në amvisëri të mbipopulluara, Romët kanë më pak gjasa të kenë qasje në pothuajse të gjitha shërbimet publike, përfshirë ujësjellësin, energjinë elektrike, kanalizimet publike dhe mbledhjen e mbeturinave. Për shembull, në vitin 2017, vetëm 75% e Romëve kishin qasje në sistemin e kanalizimit publik për dallim me 90% të jo-Romëve; 89% e Romëve kishin qasje të rregullt në energji elektrike, krahasuar me 97% të jo-Romëve; dhe 72% e Romëve vuanin nga mbipopullimi, për dallim me vetëm 49% e fqinjëve të tyre (UNDP, World Bank, 2018).

PËRFUNDIM

12 vjet nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, marrëdhëniet ndëretnike dhe dialogu brenda vendit mbeten të brishta. Ndërsa fokusi kryesor është mbi dy grupet më të mëdha etnike - Shqiptarët dhe Serbët e Kosovës - komunitetet RAE janë akoma në gjendje mjaft të pafavorshme.

Gjendja e tyre socio-ekonomike është tregues i qartë se nuk ka pasur ndonjë përkushtim serioz nga institucionet shtetërore për t'i siguruar të drejtat dhe pjesëmarrjen e të gjitha pakicave në Kosovë që rrjedhin drejtpërdrejt nga Kushtetuta dhe korniza ligjore vendase. Deri më sot, pjesa më e madhe e punës për promovimin e të drejtave dhe pjesëmarrjes së këtyre komuniteteve në Kosovë i atribuohen bashkësisë ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe organizatave në nivel të rrënjës. Ndërsa ekzistojnë strategji dhe plane të qeverisë që posaçërisht i synojnë komunitetet RAE, është e paqartë se çka kanë arritur ato për shkak të mungesës së vlerësimit të qëndrueshëm dhe konsistent.

Sfida kryesore që i rrethon komunitetet RAE është pa dyshim gjendja e tyre ekonomike e cila rrjedhimisht prekë të gjitha sferat tjera të jetës: arsimin, standardin e jetesës, qasjen në shërbime shëndetësore, strehimin, etj. Ndërsa gjendja ekonomike mbetet shqetësim kombëtar, nevojitet fokus shtesë në qasjen dhe sigurimin e arsimit për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve RAE në të gjitha nivelet. Arsimi duhet të shihet si mundësi për promovim të dialogut ndëretnik dhe bashkëjetesës përmes arsimit formal dhe joformal. Është e qartë se pa pjesëmarrjen e plotë të komuniteteve RAE, vlerat e tilla mbeten vetëm iluzion. Për më tepër, përmes arsimit cilësor, rritet vetëdijesimi dhe niveli i njohurisë në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve RAE. Kjo nga ana tjetër sjell përfitime të shumëfishta. Një gjë është e sigurt: Kosova nuk do të jetë në gjendje t'i përmbushë standardet ndërkombëtare dhe vendore të sigurisë demokratike pa përkrahjen e plotë të të drejtave të komuniteteve RAE.

REKOMANDIMET

- Institucionet e Kosovës duhet ta zgjerojnë koordinimin kombëtar dhe lokal në mënyrë që ta garantojnë zbatimin e plotë të kornizës ligjore aktualisht në fuqi në lidhje me komunitetet pakicë që jetojnë në Kosovë dhe të sigurojnë burimet financiare dhe njerëzore për zbatimin e tyre.
- Në përputhje me ligjin aktual dhe strategjinë për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare, Qeveria e Kosovës duhet të krijojë programe të veçanta të punësimit për komunitetet RAE duke e marrë parasysh gjendjen e tyre të pafavorshme socio-ekonomike. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rritjes së përfaqësimit proporcional të pjesëtarëve të RAE në shërbimin civil dhe përfaqësimin e tyre posaçërisht në pozitat e larta.
- Qeveria e Kosovës dhe posaçërisht MASHT duhet ta sigurojë zbatimin e plotë të Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021 dhe të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 - 2021 dhe t'i alokojë fondet e nevojshme për të arritur objektivat. Deri tani është shumë e paqartë se cilat objektiva janë përbushur. Vlerësimi sistematik i strategjive është parakusht për ta bërë këtë.
- Institucionet e Kosovës duhet të investojnë veçanërisht në sigurimin e qasjes së plotë të fëmijëve dhe nxënësve RAE në të gjitha nivelet e sistemit arsimor dhe veçanërisht në arsimin e detyrueshëm. Iniciativat e suksesshme, siç është shembulli i mësimin në gjuhën Rome në disa shkolla në Prizren, patjetër se duhet të shtrihen në komunat e tjera. Duhet të merret në konsideratë aftësimi special për mësimdhënësit Rom.
- Institucionet e Kosovës, së bashku me OJQ-të ndërkombëtare dhe vendore që punojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi me komunitetet, duhet t'i intensifikojnë përpjekjet e tyre me arsimin joformal në mesin e të rinjve nga komunitetet që jetojnë në Kosovë në mënyrë që t'i kontribuojnë bashkëveprimit të shëndetshëm që synon drejt harmonisë shoqërore.
- Duhet të realizohet një veprim i përbashkët për ta rritur vetëdijen për rëndësinë e arsimit dhe të drejtat e komuniteteve, dhe luftimin e diskriminimit dhe braktisjes së shkollimit, veçanërisht në mesin e vajzave dhe grave të reja.

PUNIMET E CITUARA

- Constitution of the Republic of Kosovo. (2008). *Official Gazette of the Republic of Kosovo*. Gjetur May 2020, nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>
- Datzberger, S. (2016). Peacebuilding through non-formal education programmes: a case study from Karamoja, Uganda. *Taylor and Francis Online* , 326 - 349.
- ECMI Kosovo. (2013, December 15). *Communities in Kosovo: A guidebook for professionals working with communities in Kosovo*. Gjetur April 2020, nga <https://www.ecmikosovo.org/uploads/ECMIKosovoDec2013GuidebookforProfessionalsENG.pdf>
- ECMI Kosovo. (2013, January 21). Segregation in Education in the municipality of Gjakovë/Dakovica.
- ECMI Kosovo. (2015). *Minority Communities in the Kosovo Higher Education System: Is the Reserved Quota System Being Abused*. Prishtina
- European Commission. (2015). *Youth work and non-formal learning in Europe's education landscape*. Luxembourg.
- European Commission. (2019, May 29). *Kosovo* 2019 Report*. Gjetur në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>
- Kosovo Agency of Statistics . (2018). *Education Statistics in Kosova* . Prishtina: Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”.
- Lafraya, S. (2011). *Intercultural learning in non-formal education: theoretical frameworks and starting points*. Strasbourg: Council of Europe Publishing.
- Law No. 03/L-047. (2008, June 6). *Official Gazette of the Republic of Kosovo*. Gjetur May 1, 2020, nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2531>
- Law No.02/L-37. (2006, July 27). Gjetur May 12, 2020, nga http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/2006_02-L37_en-.pdf
- Law Nr. 03/L-040. (2008, June 24). Gjetur May 12, 2020, nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530>
- Law Nr. 05/L -021. (2015, qershor 26). Gjetur May 15, 2020
- Mareva, V. (2017). Social Inclusion of Ethnic Minorities through non-formal education . *Trakia Journal of Sciences*, 359-363.
- MEST. (2016, July). KOSOVO EDUCATION STRATEGIC PLAN 2017-2021. Prishtina. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-kesp-2017-2021-1.pdf>

- Office of the Primeminister. (2017, April). Strategy for inclusion of Roma and Ashkali Communities in the Kosovo Society 2017- 2021 . Prishtina.
- Official Gazzete of the Republic of Kosovo. (2010, June 25). LAW NO.03/L –149 ON THE CIVIL SERVICE OF THE REPUBLIC OF KOSOVO
- OSCE. (2015, December 16). *Community Rights Assessment Report Fourth Edition*. Gjetur May 2020, nga OSCE Mission in Kosovo: <https://www.osce.org/kosovo/209956>
- OSCE. (2017, May). Representation of Communities in the Civil Service in Kosovo. Prishtina.
- OSCE. (2018). *Communities Access to Pre-University Education in Kosovo*. Organization for Security and Co-operation in Europe , Prishtina.
- Shaipi, K. (2013, June 12). Community Vulnerability Assessment Report.
- Stojanovski , K., Holla, A., Hoxha, I., Howell , E., & Janevic, T. (2017). The Influence of Ethnicity and Displacement on HHR_final_logo_alone.indd 1 Quality of Antenatal Care: The Case of Roma, Ashkali, and Balkan Egyptian Communities in Kosovo. *JSTOR*, 35-48.
- The Kosovo Agency of Statistics. (2014). 2013-2014 Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo Multiple Indicator Cluster Survey. Prishtina.
- UNDP. (2020, May 31). Public Pulse XVIII. Prishtina: UNDP Kosovo.
- UNDP, World Bank. (2018, April). *Roma at a Glance: Kosovo*. Gjetur May 2020, nga <https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/presscenter/articles/2018/05/03/marginalized-roma-ashkali-and-egyptian-communities-still-most-excluded-in-kosovo.html>
- UNICEF. (2020). *BUILD TO LAST: A framework in support of universal quality pre-primary education*. New York : United Nations Children's Fund .
- Uriás, K. L. (2016). The role of non-formal education for peacebuilding in Medellin, Colombia. Oslo.



www.kas.de